

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 37, datë 31.12.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET
KONSULLORE TË MINISTRISË SË
PUNËVE TË JASHTME APO TË
AMBASADAVE TONA JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 e Kushtetutës, të nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, ministri i Financave dhe ministri i Punëve të Jashtme

UDHËZOJNË:

1. Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), me institucionet e vartësisë, cakton agjentë për mbledhjen e tarifave për shërbimet konsullore, të cilat caktohen në përputhje me shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Për shërbimet që kryhen nga përfaqësitë tona diplomatike në vende të tjera, në bazë të shtojcës nr. 1, niveli i tarifës përcaktohet në euro dhe pagimi i tyre mund të bëhet në euro, dollarë ose në monedhën e vendit ku kryhet shërbimi, konvertuar me kursin përkatës ditor të këmbimit, të publikuar nga Banka e Shqipërisë.

3. Për tarifatat e arkëtuara brenda vendit, si dhe për tarifatat e arkëtuara nga përfaqësitë tona diplomatike, Ministria e Punëve të Jashtme, në cilësinë e agjentit të mbledhjes të këtyre tarifave, është e detyruar:

a) të bëjë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet;

b) të paguajë, për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën e arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës;

Për pagesën me vonesë të shumave të arkëtuara nga tarifa për agjentin, zbatohen sanksione sipas dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Për shkeljet, sipas përcaktimeve të nenit 117, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për agjentin e tarifës zbatohen sanksionet e përcaktuara në këtë nen.

c) Deklarata, bëhet në përputhje me modelin bashkëlidhur udhëzimit të ministrit të Financave nr. 26, datë 4.9.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar. Deklarata për pagesën e tarifës kombëtare plotësohet dhe dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike nga MPJ-ja nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al.

Deklarata konsiderohet e dorëzuar, në datën e dërgimit elektronik të deklaratës së plotësuar. MPJ-ja duhet të dorëzojë deklaratën edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar detyrime për tarifatat.

Mosdeklarimi brenda datës 15 të muajit pasardhës, i çdo periudhe tatimore nga agjenti i tarifës kombëtare, ndëshkohet me gjobë për mosdeklarim sipas dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

4. Me termin "përfaqësi" kuptohet përfaqësia diplomatike apo konsullore e Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Tarifatat për veprimet konsullore arkëtohen me fillimin e procedurës përkatëse.

5. Tarifatat e arkëtuara brenda vendit derdhen brenda ditës në llogarinë bankare të thesarit për llogari të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Përfaqësitë tona diplomatike raportojnë çdo muaj në Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi tarifatat e arkëtuara prej tyre. Ministria e Punëve të Jashtme transferon brenda datës 15 të çdo muaji, në llogarinë bankare të të ardhurave të thesarit, shumën totale të tarifave sipas raportimit të bërë nga përfaqësitë tona diplomatike. Çdo muaj, Ministria e Punëve të Jashtme rakordon me degët respektive të thesarit.

Shuma e tarifave të arkëtuara sipas këtij udhëzimi, i takojnë 100% buxhetit të shtetit.

6. Për vjeljen e tarifave konsullore me anën e pullës, Ministria e Punëve të Jashtme planifikon dhe porosit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, pullat konsullore për nevojat e saj dhe të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit.

7. Udhëzimi nr. 38, datë 21.11.2008, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit dhe tarifa për lëshimin e pasaportave të udhëtimit", shfuqizohet.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Ditmir Bushati

SHTOJCA NR. 1
TARIFAT PËR SHËRBIMET
KONSULLORE

I. Tarifatat për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit:

1. Për lejekalimi 200 lekë;

2. Lejekalimi lëshuar nga përfaqësitë 30 euro.

II. Tarifatat për lëshimin, verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve:

1. Certifikatë të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë 30 euro;
2. Certifikatë të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit e huaj reciprocitet;
3. Vërtetime të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë 30 euro;
4. Vërtetime të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit e huaj reciprocitet;
5. Verifikimi i dokumentit nga përfaqësitë 10 euro;
6. Legalizimi i dokumentit për shtetasit shqiptarë nga Ministria e Punëve të Jashtme 200 lekë;
7. Legalizimi i dokumentit nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë 20 euro;
8. Legalizimi i dokumentit për shtetasit e huaj reciprocitet.

III. Tarifat për lëshimin e përpilimin e akteve të tjera noteriale dhe përkthimin e dokumenteve nga përfaqësitë.

1. Përpilimi i deklaratave, autorizimeve, testamenteve kontratave, garancive dhe prokurave të posaçme nga përfaqësitë 20 euro/faqe.
2. Vërtetimi i dublikatave dhe kopjeve 20 euro/faqe.
3. Përkthimi i dokumenteve 10 euro/faqe.

